

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës – Shërbime konsulence

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: PLANI I MENAXHIMIT TË PYJEVE

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

71243000-3

VLERA E FONDIT LIMIT: : **6.750.000(gjashte milion e shtateqind e pesedhete mije)** leke (pa TVSH) , me burim financimi:“Të ardhurat e Bashkisë Vau Dejës+transferte”.

I mbajtur sot më date____.____._____, në Bashkinë Vau Dejës, në prani të anëtarëve të Njesisë së Prokurimit të ngritur me Urdhër të Titullarit të AK nr. _____ Prot., datë _____._____.2022, për miratimin e dokumentave të tenderit “Sherbim Konsulence” , me mjete elektronike, me afat 2 (dy) muaj nga nënshkrimi i kontratës.

Per objektin ne reference.

Njësia e Hartimit të Dokumentave, në hartimin e dokumentacionit të kësaj procedurë prokurimi, është mbështetur tek grupi i punës i ngritur për hartimin e nevojave, specifikimeve teknike, llogaritjen e fondit limit dhe kriterëve të vecanta teknike, të procedurës ne reference.

Gjithashtu NJP është bazuar në nenin 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenin 2, pika 2/c dhe nenin 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor.Njësia e Prokurimit, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve të vecanta teknike.

Njësia e prokurimit, bazuar në parashikimet ligjore dhe në objektin e prokurimit, vendosi kriteret e kualifikimit, kriteret të cilat u konsideruan si të nevojshme për përmbushjen e kontratës, në përpjestim me përmasat dhe veçoritë e objektit që prokurohet dhe konkretisht, si më poshtë vijon: Kriteret e Përgjithshme të Pranimi/Kualifikimit, janë të pa ndryshueshme nga ato të miratuar nga APP në setin standard të dokumentave të tenderit.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas percaktimeve të bëra në Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30 % e vlerës së Fondit Limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 55, dhe sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”. Referuar parashikimeve ligjore të nenit 43, pika 2, germa c), për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, siç është rasti i kësaj procedure.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në VKM “Për rregullat e prokurimit publik”, e cila parashikon se Autoriteti Kontraktor për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike mund të kërkojë për një periudhë maksimumi deri në 3 vitet e fundit financiare. Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Kontraktor.

2.2.2 Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2022** prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi sipas kësteve. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës. *Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020 dhe 2021, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe neni 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të

ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së perlllogaritur të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 20 % të vlerës së perlllogaritur të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nenit 41, pika 3, në vlerën jo më të madhe se 40% e vlerës së perlllogaritur të kontratës që

prokurohet; dhe nenit 55 pika 4/b. Kemi zgjedhur marzhin 20% duke marrë parasysh vlerën e fondit limit të kontratës dhe me qëllim nxitjen e konkurrencës, pa cënuar garancinë e përmbushjes së kontratës.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Licencë të lëshuar nga QKL me Kod III.7.A “shërbime të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me pyjet apo kullotat”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 41, pika 4, gërma a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i cili përcakton se: ”Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; si dhe në VKM 538 datë 28.05.2009, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e këtij shërbimi.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate duhet të vërtetojë/disponojë që ka të punësuar :

a. 1 (nje) inxhinier pyjesh i licencuar

Inxhinieri i pyjeve duhet te jete i pajisur me "Certifikate personale", per shërbime profesionale për projektme sipas gërmes (c), pika 1 e Rregullores Nr. 3, datë 08.07.2009, "Per certifikimin e shërbimeve te ekspertizes dhe profesionale ne pyje dhe kullota". Cerifikata leshohet nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

b. 1 (një) topograf

Inxhinieri topograf/gjeodet duhet te jete i pajisur me licence profesionale individuale "Projektues Gjeodet", Kategoria 8.E, sipas lidhjes 2 te VKM nr. 759, date 12.11.2014 "Per licencimin profesional te individeve dhe subjekteve juridike qe do te ushtrojne veprimtari ne fushen e studimit dhe projektimit ne ndertim dhe mbikqyrjes e kolaudimit te punimeve te zbatimit ne ndertim", i ndryshuar. Licenca leshohet nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise.

c. 1 (një) agronom

d. 1 (një) teknik pyjesh

- Staf i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

Në rast se shpallet fitues, për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Kontratën individuale të punës, dhe b) Diplomën c) Licencen profesionale (ku aplikohet)
 - d) Cv e stafit
- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për të paktën muajin e fundit.
 - Listëpagese e muajit të fundit të punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, sipasformatit E-Sig 025/a.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve të kërkuar është një numër minimal dhe i nxjerrë bazuar në orët e punës që nevojiten.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Termet e References dhe Specifikimet janë hartuar nga specialistet e fushes, bashkëngjitur DST ne SPE.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termet e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si

dhe nenit 41, pika 1, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuarçdokërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

1. TË PËRGJITHSHME

Në kuadër të reformës administrativo-territoriale, Bashkisë Vau Dejës, nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 433, datë 08.06.2016,i ndryshuar “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish komunave/bashkive”, i kanë kaluar në pronësi sipërfaqet e fondit pyjor në territorin e Bashkisë.

Duke patur parasysh se planet e Inventarizimit (Mbarështimit), janë hartuar në vitin 1985, gjatë këtyre viteve në këto ekonomi pyjore kanë ndodhur ndryshime të mëdha, të cilat kanë ardhur si rezultat i shfrytëzimeve të lëndës drusore, ndërhyrjeve të paligjshme, dëmtimet nga rënia e zjarreve, zënia e sipërfaqeve pyjore me anë të shpyllëzimeve, etj., si në sipërfaqe dhe volum, të cilat nuk janë pasqyruar në regjistrat kadastral të fondit pyjor ndër vite.

1.1 Ekonomia Pyjore “Gomsiqe”

Kjo ekonomi pyjore shtrihet në Njësitë Administrative Qender Vau Dejës. Kjo ekonomi pyjore shtrihet në Njësinë Administrative Qendër,Bashkia Vau Dejës . NJ.A ka si qendër të saj Bashkinë Vau Dejës dhe lidhet me qytetin e VAU DEJËS nëpërmjet rrugës automobilistike Vau- Dejës Koman .

Nisur nga pikpamja gjeografike këto pyje shtrihen tërësisht mbi shpatet dhe luginat ,te cilat pergjithesisht per përbëjnë bazenin lindor dhe perendimor te Liqenit Vau Dejës.Lartësia mbi nivelin e detit fillonn nga 70m der ne 800 m .

Nisur nga vëzhgimi topografik pyjet dhe kullotat e kësaj EP janë të stigmatizuara në hartat topografike të shkallës 1:25000 me nomenklaturën bazë:

K-34-64-C-d

Përbërja e territorit për ekonominë Gomsiqe është si më poshtë:

Nr	Rregjimi	Sip ha
1	Trungishe	909.57
2	Cungishte	1891.94
3	Shkurre	855.15
4	Kullote	366.3
5	Djerre	158.45
6	Shkembore	158.47
Shuma		4339.88

1.2 Ekonomia Pyjore Drin Gjadër Kir

Kjo ekonomi pyjore shtrihet në Njësinë Administrative Bushat, Bashkia Vau Dejës . NJA Bushat ka si qendër të saj Fshatin Bushat dhe lidhet me qytetin e VAU DEJËS Dhe Bashkine nëpërmjet rrugës automobilistike Bushat –Vau Dejes .

Nisur nga pikpamja gjeografike këto pyje shtrihen tërësisht ne pjese fushore dhe ne afersi te qendrave te banuara Stajka e kosmaç.

Nisur nga vëzhgimi topografik pyjet dhe kullotat e kësaj EP janë të stigmatizuara në hartat topografike të shkallës 1:25000 me nomenklaturën bazë:

K-34-64-C-c ;K-34-76-A-a.

Përbërja e territorit për ekonominë Drin Gjader Kire është si më poshtë:

NR	Rregjimi	Sip ha
1	Cungishte	122.53
2	Ranishte	293.46
	Shuma	415.99

2. FONDI LIMIT PËR HARTIMIN E PLANEVE TË MBARËSHTIMIT

Në përputhje me parashikimet e kuadrit ligjor në fuqi për prokurimin publik, nga ana e autoritetit kontraktor është realizuar përlllogaritja e fondit limit që do të përdoret për kontraktimin e subjektit/eve që do të hartojnë planet e reja të mbarështimit të ekonomive pyjore.

Për shkak të karakteristikave të ndryshme që kanë ekonomitë pyjore të përzgjedhura për planet e reja (sipërfaqe, lloji pyjor, vështirësi terreni etj.), fondi limit është përlllogaritur për çdo ekonomi. Përlllogaritja e fondit limit e planifikuar për hartimin e planeve të mbarështimit është realizuar mbështetur në VKM-në Nr. 361, datë 12.05.2010, “Për miratimin e tarifave të shërbimeve profesionale që kryhen në fondin pyjor e kullësor publik”, dhe bazuar në mundësitë investuese, e cila paraqitet në pasqyrat e mëposhtme sipas ekonomive pyjore.

2.1 Fondi limit për planin e mbarështimit të EP “Fag”

1. Fondi limit për hartimin e planit të mbarështimit të ekonomisë pyjore “Gomsiqe” është përlllogaritur në vlerën e 6.251.000 (gjashtë milion e dyqind e pesëdhjetë e një mijë) lekë pa TVSH

Ekonomia Pyjore	Forma e qeverimit	Sipërfaqja (ha)	Çmimi për njësi lekë/ha	Vlera totale lekë
“Gomsiqe”	Trungishte (Klasa IV e lartë e moshës)	560.11		
	Trungishte (Klasa I-III e moshës)	349.46		
	Cungishte	1891.94		
	Shkurre	855.15		
	Kullota, livadhe	366.3		
	Tok me bim. pyj+Inprod.+djerr+tjera	316.92		
Totali i ekonomisë pyjore		4339.88		
TVSH 20 %				
T O T A L I				

2.2. Fondi limit për planin e mbarështimit të EP “Drin Gjadër Kir”

1. Fondi limit për hartimin e planit të mbarështimit të ekonomisë pyjore “Rovë-Lunxhë” është përlogaritur në vlerën e 499.000 (katerqind e nenetedhjetë e nente mijë) lek pa TVSH

Ekonomia Pyjore	Forma e qeverimit	Sipërfaqja (ha)	Çmimi për njësi lekë/ha	Vlera totale lekë
“Drin Gjadër Kirë”	Trungishte (Klasa I - III e moshës)	0		
	Cungishte	122.53		
	Shkurre	0		
	Kullota, livadhe	0		
	Tok me bim.pyj+Inprod.+djerr+tjera	293.46		
Totali i ekonomisë pyjore		415.99		
TVSH 20 %				
TOTALI				

2.4 Fondi total për hartimin e planeve të mbarështimit

1. Fondi limit në total për hartimin e planeve të mbarështimit për tre ekonomitë pyjore është përlogaritur në vlerën prej 6.750.000 (gjashtë milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lek pa TVSH

Ekonomitë Pyjore	Forma e qeverimit	Sipërfaqja (ha)	Çmimi për njësi lekë/ha	Vlera totale lekë
	Trungishte (Klasa IV e lartë e moshës)	560.11		

“Gomsiqe” “Drin Gjadër kirë”	Trungishte (Klasa I-III e moshës)	349.46		
	Cungishte	2,014.47		
	Shkurre	855.15		
	Kullota, livadhe	366.3		
	Tokë me bimë pyjore+Inprod.+djerr	610.38		
Totali i ekonomive pyjore		4,755.87		
TVSH 20 %				
T O T A L I				

3. TERMAT E REFERENCËS

Termt e e references me të gjithë elementët përbërës janë hartuar mbështetur në MANUALI I PLANEVE TË MBARËSHTIMIT TE PYJEVE DHE KULLOTAVE të miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot, date 30.01.2019.

Manuali përcakton në mënyrë të detajuar kërkesat që duhet të plotësojë subjekti i kontraktuar gjatë fazës së punimeve të terrenit dhe ato të perpunimit të dhënave në zyrë.

3.1 KONTEKSTI

Me reformen administrative dhe Ligjin Nr 115/2014, Republika e Shqipërisë ka krijuar njesite e reja administrative ose Bashkite ku nga bashkimi i njesive administrative te meparshme prej 361 komunash dhe bashkish tashme kemi vetem 61 Bashki.

Me keta kufij te rinj kerkohet edhe percaktimi i ekonomive pyjore dhe hartimi i planeve te reja te mbareshtimit bazuar ne keto parime:

- planet do perdoren per trungishtet, cungishtet, shkurret si dhe kullotat qe jane brenda kufijve te Bashkise dhe keto plane do quhen Plane te Mbareshtimit te Pyjeve dhe Kullotave.
- do te mbulojne te gjithe tipet e pronesise se pyjeve dhe kullotave
- periudha e vlefshmerise se planit eshte 10 vjet
- secili PMPK hartohet per 1 ekonomi pyjore. Baza per krijimin e njesive te reja te mbareshtimit do te jene ekonomite ekzistuese pyjore, por sistemi i ri i mbareshtimit eshte unik.

- PMPK te pergatitet duke perdorur mundesite aktuale te teknologjise ne termat e lidhjes se internetit dhe perdorimin e mjeteve informatike te reja sidomos ne lidhje me SISP qe menaxhon te dhenat e pyjeve dhe kullotave ne Shqiperi.

- PMPK bazohet ne klasifikimet e standartizuara qe jane te zakonshme per te gjitha planet dhe projektet e tjera si psh: IKP dhe keto do jene te pershtatshme edhe per SISP.

Menaxhimi i procesit per hartimin e PMPK eshte pergjegjesi e Bashkise.

3.2 OBJEKTIVAT

Detyra per hartimin e Planeve te reja te Mbareshtimit te Pyjeve dhe Kullotave per nje ekonomi pyjore synon qe te arrije objektivat e meposhtme:

1. pergatitjen e nje plani shumefunksional duke mbuluar aspektet ekonomike, sociale dhe ekologjike
2. njohja e burimeve lokale duke perfshire siperfaqet pyjore dhe jo pyjore, produktet drusore dhe jodrusore, kullotat dhe produktet e tyre, gjendja e turizimit dhe fasilitetet didaktike dhe te kerkimit shkencor.
3. njohja e problemeve lokale si: erozioni, rreshqitjet, zjarret ne pyje, prerja ilegale, mbikullotja etj.
4. pergatitja aktive dhe pjesmarrja ne te gjitha hapat e procesit te pjesmarrjes duke perfshire aktoret lokale ne hartimin dhe menaxhimin e PMPK.
5. menaxhimi i punes per hartimin e planit dhe futjen e tij ne SISP
6. përcaktimi i ndërhyrjeve per periudhen e vlefshmerise se planit te mbarështimit
7. mbeshtetja e Bashkise ne te gjitha fazat e hartimit te planit deri ne miratimin e tij nga MTM.

Ekonomia pyjore dhe kullosore per te cilen do te hartohet plani i mbareshtimit jepet ne tabelen e meposhtme:

Nr	Rregjimi	Sip ha
1	Trungishe	909.57
2	Cungishte	1891.94
3	Shkurre	855.15
4	Kullote	366.3
5	Djerre	158.45
6	Shkembore	158.47
Shuma		4339.88

3.3. QELLIMI I SHERBIMIT

Hartimi i PMPK duhet te behet bazuar ne parimin e mbareshtimit te qendrueshem qe nenkupton "te ruaje dhe te forcoje gjendjen shendetsore te ekosistemeve pyjore per nje afat kohe te gjate dhe ne te njejten kohe per te siguruar mundesi ekologjike, sociale, ekonomike dhe kulturore per mireqenien e brezave aktuale dhe atyre te ardhshem".

Ky plan hartohet per ekonomite pyjore qe jane pjese e Bashkive dhe natyrisht ne kordinim edhe me njesite e tjera ekonomike fqinje apo zonat e mbrojtura nese eshte e nevojshme.

Hartimi i planit te mbareshtimit eshte nje mjet per te njohur gjendjen aktuale te territorit, siguron nje ndeveprim me aktoret dhe bashkite si dhe kordinim me institucionet qendrore nepermjet perdorimit te SISP dhe kjo pritet te ndodhe gjate hartimit te PMPK dhe gjate drejtimit te nderhyrjeve dhe ngjarjeve ne periudhen e vlefshmerise se planit. Perdorimi i nje metode te standartizuar te punes e percaktuar ne Udhezuesin e Planeve te Mbareshtimit te Pyjeve dhe Kullotave 2019, duhet te sherbeje per te siguruar rezultate homogjene dhe te krahasueshme ne nivel lokal duke perdorur proçedurat qe ofrohen nga SISP.

Sipas Udhezuesit, proçesi i hartimit te PMPK duhet te zhvillohet sipas ketyre hapave:

- Puna pergatitore
- Puna ne terren
- Puna ne zyre

Puna e eksperteve te jashtem duhet gjithmone te zhvillohet ne bashkepunim te ngushte me Bashkine dhe stafin pyjor lokal si nje kusht themelor per te siguruar rezultate te mira. Me poshte jepet nje skeme e permbajties se proçesit, por hartimi i PMPK duhet absolutisht te zhvillohet sipas percaktimeve te Udhezuesit 2019.

3.4 PUNA PERGATITORE

- Grumbulli i te dhenave ekzistuese dhe dokumentave te nevojshme per hatimin e PMPK
- Futja ne SISP e planit te ri te mbareshtimit dhe menaxhimi i proçesit te punes
- Organizimi dhe menaxhimi i proçesit te pjesmarrjes se aktoreve

3.5 PUNA NE TERREN DHE PERSHKRIMI PARCELAR

- Vizitat ne terren
- Hartimi i hartes paraprake dhe ndertimi i rrjetit te siperfaqeve prove
- Mjetet per punen e terrenit

Puna ne terren duhet te kryhet duke perdorur mjete elektronike si: GPS dhe tablete per grumbullimin e informacionit ne siperfaqet prove.

- Planifikimi inventarizimit dhe pershkrimi i rrjetit te siperfaqeve prove
- Metoda e inventarizimit dhe kampionimi per matjet e kullotave
- Futja e te dhenave dhe kontrolli

- Pershkrimi parcelar
- Te dhenat parcelare dhe lidhja me Kadastrën Pyjore dhe SISP

3.6 PUNA NE ZYRE-RAPORTIMI

Proçesi për hartimin e Planit të Mbareshtimit të Pyjeve dhe Kullotave duhet të respektoje standartet në mënyrë që të përfitohen produkte finale homogjene (raporti, të dhënat, hartat etj) me qëllim përpunimin e të dhënave, transferimin e tyre në SISP dhe një koherencë me IKP.

Pjesët e shkruara të raportit, tabelat dhe hartat duhet të jenë në përputhje me udhëzimet e dhëna në Udhëzuesin 2019 për Planet e Mbareshtimit të Pyjeve dhe Kullotave.

Sekuënca e përmbajtjes duhet të ruhet. Parimi i shkrimit të raportit është: "shkruaj shkurt dhe thjesht".

Struktura e raportit jepet me poshtë:

- Hyrje
- Gjendja e Ekonomisë Pyjore në të kaluarën
- Gjendja aktuale e Ekonomisë pyjore
- Pershkrimi i kushteve stacionale
- Vegjetacioni dhe biodiversiteti
- Lista e parcelave pyjore në Ekonominë Pyjore
- Pershkrimi i pyjeve dhe kullotave
- Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave
- Funksioni i pyjeve dhe kullotave
- Mbareshtimi i pyjeve
- Mbareshtimi i Kullotave
- Masat dhe nderhyrjet
- Planifikimi vjetor i nderhyrjeve
- Vlerësimi ekonomik i nderhyrjeve të planifikuara
- Transferimi i planit tek SISP

3.7 PËRGATITJA E HARTAVE

Ato duhet të realizohen në sistemin GIS. Hartat që do të përgatiten janë:

1. Harta e Ekonomisë Pyjore
2. Harta e Funksioneve
3. Harta e tipeve të pyjeve, shkurreve dhe kullotave
4. Harta e rrjetit rrugor, infrastruktures dhe sipërfaqeve të degraduara
5. Harta e nderhyrjeve

3.8 RAPORTET

- *Raporti Fillestar*: Është raporti fillestar i hartuar pas përfundimit të hapit të parë lidhur me prezantimin e tij tek të gjithë palët e interesit, vizitat e para në terren, krijimin e grupeve të punës, përcaktimin e metodologjisë për punën e terrenit, përgatitjen e hartave baze dhe ndertimin e rrjetit të sipërfaqeve prove. Ky raport duhet të dorëzohet brenda 60 ditëve nga firmosja e kontratës.

- Draft raporti i Planit të Mbareshtimit eshte raporti i dyte. Ky raport duhet te hartohet ne perputhje me udhezuesin e PMPK.

- *Raporti Final*, pas miratimit nga Bashkia dhe MTM

Detyrat që ndiqen për hartimin e planit të mbarështimit

Detyrat që duhet të zbatohet subjekti i kontraktuar me qëllim hartimin e planit të mbarështimit të pyjeve janë:

➤ Grumbullimi dhe shqyrtimi i literaturës për të vlerësuar gjendjen aktuale të burimeve pyjore/kullosore në ekonominë pyjore;

➤ Përshkrimi i përgjithshëm në terren i ngastrave e n/ngastrave, verifikimi i kufijve, përcaktimi definitiv në terren duke shënjuar me bojë vaji kufijtë e tyre, hedhja e ndryshimeve në hartë dhe llogaritja e sipërfaqeve përkatëse; gjate punes (ne terren apo ne zyre) të mbahet parasysh se nuk duhet ndëruar numri dhe madhesia e parcelave nga ai aktuale, mund te kete shtese apo paksim te nenparelave sipas rastit por brenda konturit aktual te parceles.

➤ Vlerësimi i sipërfaqes dhe volumit të pyjeve sipas formave të ndryshme të qeverisjes:

- Trungishte

- Cungishte

- Shkurre

➤ Vlerësimi kullotave/livadhe, përfshirë kapacitetin prodhues të tyre si dhe atë mbajtës;

➤ Vlerësimin e llojshmërisë dhe sasisë së prodhimeve jo-pyjore (prodhimeve të dyta);

➤ Identifikimi i problematikës lidhur me aspektet menaxhuese të pyjeve;

➤ Identifikimi i çështjeve kyçe që kanë të bëjnë me aspektet ligjore, administrative dhe ato të menaxhimit, faktorët dhe aktorët që influencojnë;

➤ Identifikimi i zgjidhjeve sociale bazuar në potencialet ekologjike të zonës;

➤ Eksplorimi dhe propozimi i alternativave më të mira të menaxhimit të bazuara dhe të integruara në nevojat e ruajtjes dhe zhvillimit të fondit pyjor dhe të komunitetit të zonës;

➤ Hartografimi i territorit të zonës duke përfshirë:

- Ekonominë pyjore, ndarjen e ngastrave e të n/ngastrave, llojet pyjore dhe format e qeverisjes;

- Përdorimin e territorit të zonës;

- Masat e propozuara të parashikuara për përmirësimin dhe trajtimin e pyjeve;

- Rrjetin e përhershëm dhe të përkohshëm të sipërfaqeve provë;

➤ Ngritjen e një sistemi të përhershëm dhe përkohshëm sipërfaqesh provë për matjen (dhe më tej monitorimin periodik) dhe llogaritjen e volumit të pyjeve, bazuar në udhëzuesin përkatës të hartimit të planit të mbarështimit;

➤ Marrja e profileve të tokës për çdo tip toke dhe kategori thellësi;

➤ Zhvillimi i një vizioni, misioni dhe objektivi kryesor të menaxhimit për ekonominë pyjore;

➤ Propozimi i strategjive të duhura të menaxhimit, si dhe planit të veprimit;

➤ Plani i monitorimit të menaxhimit dhe aktiviteteve që priten të zhvillohen në zonë;

➤ Hedhja e të dhënave të grumbulluara në terren dhe përpunimi kompjuterik i tyre;

➤ Diskutimi dhe konsultimi i aktiviteteve kryesore të planifikimit dhe zbatimit të planit të menaxhimit me palët e interesuara;

➤ Konsultimi i draft-planit të menaxhimit me aktorët vendimarrës (Bashkia Vau Dejës, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Njësitë Administrative, banorët, shoqatat , perdoruesit etj).

➤ Ripunim materiali pas vërejtjeve të bëra.

3.9 Objektivat e përgjithshme dhe specifike të planit të mbarështimit

Objektivi i përgjithshëm i planit të mbarështimit duhet të jetë menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve pyjore/kullosore në pronësi të Bashkisë Shkoder (edhe nga këndvështrimi ekologjik), me strukturë dhe cilësi të mirë në përshtatje me kushtet e zonës dhe në përputhje me objektivat e mbarështimit.

Objektivat specifike të planit të mbarështimit do të jenë:

- Përcaktimi i përdorimit të territorit në përputhje me gjendjen lokale dhe nevojat;
- Optimizimi i formës së qeverisjes në përputhje me nevojat lokale, mundësitë e grumbullit pyjor dhe mjedisit për të përmirësuar prodhimtarinë;
- Optimizimi i funksioneve ndërmjet nevojave dhe mundësive ekologjike/silvikulturale në përputhje me rëndësinë multifunksionale, sociale dhe mjedisore të pyjeve;
- Përmirësimi dhe mirëmbajtja në një gjendje të mirë funksionale të grumbujve pyjor;
- Rritja e prodhimtarisë së pyjeve me funksion prodhues;
- Përmirësimi i cilësisë dhe gjendjes së grumbujve të trungishteve me funksion prodhues;
- Nxitja dhe përdorimi i ripërtëritjes natyrore sa më shumë që të jetë e mundur me qëllim që të krijohen ekosisteme pyjore që i përshtaten mjedisit;
- Pakësimi i impakteve negative në gjendjen fitosanitare të pyjeve, dhe prerjeve të paligjshme;
- Rehabilitimi dhe garantimi i rritjes së qëndrueshme të prodhimtarisë në sipërfaqet pyjore/kullosore;
- Sigurimi i pjesëmarrjes së gjërë të popullsisë lokale në marjen e vendimit për menaxhimin e pyjeve/kullotave;
- Përmirësimi i menaxhimit të pyjeve duke lidhur resurset pyjore/kullosore me interesat e përdoruesve.

Përmbajtja e Planit të mbarështimit të Ekonomisë Pyjore do të përbëhet nga dhe jo vetëm:

1. HYRJE
 2. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I EKONOMISË
 3. GJENDJA AKTUALE E PYLLIT
 4. VLERËSIMI I MBARËSHTIMIT TË MËPARSHËM
 5. OBJEKTIVAT E MBARËSHTIMIT
 6. MASAT PËR MBARËSHTIMIN E PYLLIT
 7. GJENDJA DHE MASAT PËR INFRASTRUKTURËN
 8. PLANIFIKIMI EKONOMIK
 9. INDIKATORËT PËR MONITORIM DHE VLERËSIM
 10. UDHËZIME PËR REVIZIONIMIN E PLANIT TË MBARËSHTIMIT
 11. PLANI 10 VJEÇAR I PUNIMEVE TË PROPOZUARA SIPAS KATEGORIVE TË PUNIMEVE
- PJESA E DYTË (Përshkrim parcelar)

Lista e ngastrave, n/ngastrave me të dhënat kryesore.

PJESA E TRETË

INVENTARIZIMI

Rezultatet e sipërfaqeve prove etj

PJESA E KATËRT

Harta e gjendjes ekzistuese (përdorimi i territorit)

Harta e punimeve të propozuara

Harta e përhapjes së llojeve drusore

Harta e ekonomisë pyjore sipas nën/ngastrave (Ortofoto)

Harta e shtrirjes së sipërfaqeve prove të përhershme dhe të përkohshme etj

Inventarizimi i grumbujve dhe metoda e punës për hartimin e planit të mbarështimit do të bazohet në

Inventarizimi i grumbujve dhe metoda e punës për hartimin e Planit të Mbarështimit do të bazohet në Manualin e Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave 2019, miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot., datë 30.01.2019.

Plani i mbarështimit i hartuar nga kontraktori së bashku me hartat pyjore dhe dokumentacioni shoqërues do të dorëzohen pranë autoritetit kontraktor në 4 kopje të printuara dhe 4 kopje në format elektronik (CD).

3.10 AFATI I HARTIMIT TË PLANEVE TË MBARËSHTIMIT

Për realizimin e hartimit të planit të mbarështimit për këto ekonomi pyjore parashikohet një afat kohor 2 mujor që fillon me nënshkrimin e kontratës me subjektin e kontraktuar. Kontraktori duhet të parashikojë dhe të detajojë në mënyrë të saktë të gjitha fazat e punës së domosdosshme deri në momentin final, atë të miratimit dhe dorëzimit të produktit përfundimtar.

3.11 STAFI DHE EKSPERIENCA

Bazuar në pikën 3, neni 5, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar, subjekti do të duhet të jetë i pajisur me licencë III.7.A, sipas shtojcës së ligjit për licencat dhe duhet të ketë eksperiencë jo më pak se 5 vjet dhe të ketë kryer punë të ngjashme . Duhet të ketë në përbërje staf pune të kualifikuar për hartimin e planit të mbarështimit dhe me eksperiencë në fushat respektive të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave.

Stafi i kontraktorit duhet të ketë në përbërje specialistë të profileve si më poshtë:

a. 1 (nje) inxhinier pyjesh i licencuar

Inxhinieri i pyjeve duhet të jetë i pajisur me "Certifikate personale", për shërbime profesionale për projekttime sipas gërmes (c), pika 1 e Rregullores Nr. 3, datë 08.07.2009, "Per certifikimin e shërbimeve të ekspertizës dhe profesionale në pyje dhe kullota". Cerifikata leshohet nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

b. 1 (një) topograf

Inxhinieri topograf/geodet duhet të jete i pajisur me licence profesionale individuale "Projektues Gjeodet", Kategoria 8.E, sipas lidhjes 2 te VKM nr. 759, date 12.11.2014 "Per licencimin profesional te individeve dhe subjekteve juridike qe do te ushtrojne veprimtari ne fushen e studimit dhe projektimit ne ndertim dhe mbikqyrjes e kolaudimit te punimeve te zbatimit ne ndertim", i ndryshuar. Licenca leshohet nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise.

c. 1 (një) agronom

d. 1 (një) teknik pyjesh

Eksperienca e punës dhe profilet e specialistëve duhet të vërtetohen nga ana e operatorit ekonomik me kontratat individuale të punës , diplomat dhe/ose cdo kualifikim tjetër profesional, dhe jetëshkrimet(CV).

3.12 MONITORIMI I FAZAVE TË HARTIMIT TË PLANIT TË MBARËSHTIMIT

Autoriteti kontraktor do të monitorojë fazat e ndryshme të hartimit të planit të mbarështimit dhe punimet që realizohen nga subjekti kontraktor nëpërmjet grupit të monitorimit që do të ngrihet me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor.

3.13 MIRATIMI I PLANIT TË MBARËSHTIMIT

Plani i mbarështimit të ekonomisë pyjore i hartuar nga kontraktori, pasi ti nënshtrohet konsultimit me aktorët e fushës (Nj.A. shoqatat e pyjeve, komunitetit) do të dërgohet zyrtarisht për konfirmim në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

Në zbatim të parashikimeve të ligjit 57/2020 “Për pyjet”, plani i mbarështimit pasi të konfirmohet nga Këshilli Bashkiak dërgohet tek ministria përgjegjëse për pyjet për miratim përfundimtar.

Plani i mbarështimit të ekonomisë pyjore do të merret në dorëzim nga përfaqësuesit e autoritetit kontraktor pasi të jetë marrë konfirmimi nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

3.14 REFERENCA LIGJORE

Gjatë hartimit të këtij projekti janë mbajtur në konsideratë detyrimet që lindin nga kuadri ligjor në fuqi në fushën e menaxhimit të pyjeve dhe në fushën e prokurimit publik.

Kuadri ligjor përkatës përbëhet nga:

- Ligji Nr. 57/2020 datë 30.4 2020 “Për pyjet”, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 433, date 08.06.2016, i ndyshuar për “Transferimin në pronësi të bashkive, të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/ Bashkive”; lidhja 49
- Manualin e Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave 2019, miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot., datë 30.01.2019.
- Plane dhe strategji kombëtare / rajonale dhe bashkiake në funksion të planifikimit dhe Zhvillimit të qëndrueshëm.(Plani I përgjithshëm vendor I bashkisë Vau Dejës, etj). Plan i Menaxhimit të Pyjeve ish Bashkisë Vau Dejës.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 361, datë 12.05.2010, “Për miratimin e tarifave të shërbimeve profesionale që kryhen në fondin pyjor e kullor publik”;

➤ Urdhër i Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës Nr. 36, date 02.02.2022, Për “Ngritjen e grupit të punës, për përlogaritjen e fondit limit dhe përcaktimin e termave të referencës për procedurën e hartimit të planeve të mbarështimit, të ekonomive pyjore”.

Shenim: Per cdopaqartesilidhur me termat e references, duhet ti referohen MANUALITË PLANEVE TË MBARËSHTIMIT TE PYJEVE DHE KULLOTAVE të miratuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot., datë 30.01.2019.

Afatet e shërbimit: Sipas nevojave dhe kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga data e lidhjes se kontratës 2 muaj.

Dokumentacioni pasi u firmos nga të tre anëtarët e Njesisë së Prokurimit, pasi u përpilua edhe formulari përmbledhës i njoftimit të kontratës, do ti paraqitet titullarit të autoritetit kontraktor për tu firmosur dhe u ra dakort që të hidhen në formatin e sistemit elektronik për shpallje dhe botim nga APP.

NJËSIA E PROKURIMIT: